

URDHËR
Nr. 82, datë 1.8.2012

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES MBI SHËRBIMET METEOROLOGJIKE
NË NAVIGIMIN AJROR

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 4 të nenit 78 të ligjit nr. 10 040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullores “Mbi shërbimet meteorologjike në navigimin ajror” sipas tekstit, shtojcave, materialeve udhëzuese dhe ilustruese përkatëse, që i bashkëlidhen këtij urdhri dhe janë pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për zbatimin e kësaj rregulloreje, si dhe për hartimin dhe nxjerrjen e procedurave përkatëse teknike për zbatimin e saj.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi